



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 10 Tetor 2023

Nr: 799

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 348 ID TË KOALICIONIT PËR  
REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA, PËR SHKELJE  
ADMINISTRATIVE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14  
MAJ 2023**

Sot më datë 10 Tetor 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

**KËRKUES:** Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara

**SUBJEKT:** Z. Erjon Veliaj, kryetar dhe njëkohësisht kandidat për kryetar për bashkinë Tiranë

**OBJEKT:** Shqyrtim administrativ për shkelje administrative në kundërshtim me parashikimet e nenit 91, të Kodit Zgjedhor

**BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**K O N S T A T O J :**

Data: 10 Tetor 2023

Nr: 799  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit, për shkelje administrative”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka marrë indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike, për të cilat pretendohet se ka patur përdorim të burimeve shtetërore për qëllime zgjedhore.

Denoncimi është marrë nëpërmjet provave link apo provave shkresore, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në vijim të procedurës administrative, filloi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtarinë objekt denoncimi.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për bashkinë Tiranë, nëpërmjet adresës së postës elektronike email, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

Subjektet objekt i këtij vendimi kanë paraqitur pretendime si më poshtë vijon:

- Denoncimi **regjistruar me nr. 348 ID**, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 25.04.2023, nëpërmjet raportit XIV të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, nëpërmjet sëcilit pretendohet si më poshtë vijon:

*“Në mbledhjen e datës 19 Prill 2023, të Këshillit Bashkiak të Tiranës shkelje që përbëjnë përdorim të burimeve shtetërore për avantazh elektoral nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliq. Konkretisht, fjala e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliq, gjatë mbledhjes së Këshillit Bashkiak të 19 Prillit 2023, në gjykimin e KRIIK është një fjalë me natyrë të pastër elektorale. Përgjatë gjithë fjalimit, z. Veliq ka bërë një numër komentesh me natyrë të qartë elektorale, duke komentuar negativisht subjekte zgjedhore konkurrenente në këto zgjedhje*

*(konkretisht në lidhje me Koalicionin “Bashkë Fitojmë”), duke komentuar elementë të programit elektoral të kandidatit për Kryetar Bashkie të po këtij Koalicioni, madje edhe duke u shprehur në lidhje me pritshmëritë e rezultatit zgjedhor në favor të tij.*

*Për më tepër, në një numër të komenteve të kryera është përdorur një gjuhë denigruese si dhe sulme personale. Për më tepër, mbledhja e djeshme e Këshillit Bashkiak ishte një mbledhje e transmetuar gjërësisht në media. Përveçse e transmetuar në kohë reale në faqen e Bashkisë Tiranë në Facebook (çka përbën edhe një tjetër mënyrë se si burimet institucionale janë përdorur për efekte fushate) apo të tjera faqe në rrjete sociale, ajo është transmetuar po në kohë reale nga së paku 5 televizione (shih Lidhjen Nr. 5, foto/screenshots nga mediat që kanë transmetuar në kohë reale Mbledhjen e Këshillit Bashkiak të datës 19 prill 2023).*

*Gjithë sa më sipër bëhet akoma më problematike nëse konsiderojmë se tanimë jemi në fazën më intensive të takimeve të kandidatëve me elektoratin, atë të fushatës zgjedhore. Kryetari i Bashkisë Tiranë e përdori mbledhjen e djeshme të Këshillit Bashkiak dhe pozicionin e tij zyrtar si Kryebashkiak për të përfutur një avantazh elektoral ndaj konkurrentëve të vet në garë, duke dëmtuar në këtë mënyrë barazinë në garë, në shkelje të parimeve për zgjedhje të ndershme dhe demokratike, përveçse në shkelje të Kodit Zgjedhor dhe të Vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator.*

*Përpos sa më sipër, KRIIK gjithashtu sjell në vëmendjen tuaj se natyra e vendimeve të djeshme të Këshillit Bashkiak është e tillë që qartas përbëjnë vendime me efekt elektoral, për të cilat KQZ-ja duhet të investohet për të mbajtur qëndrimin e duhur që ligji i ngarkon”.*

Më datë 26.4.2023, në kuadër të hetimit administrativ personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për bashkinë Tiranë i është kërkuar informacion sqarues në lidhje me pretendimet e denoncuesit, por personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike nuk i është përgjigjur kërkesës sonë.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 5 Maj 2023, ora 12:30, ku u ftuan në këtë proces palët për denoncimin regjistruar me nr. 348 ID, duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Në seancë nuk u paraqit asnjë përfaqësues nga bashkia Tiranë.

Për shkak të kompleksitetit të çështjes, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimit nr. 673, datë 26 Qershor 2023 “Për zgjatjen e afatit të hetimit administrativ për denoncimet nr. 334 ID dhe 348 ID” ka vendosur zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 348 ID.

Në vijim të shqyrtimit administrativ, pas konsultimit me të gjitha provat dhe faktet, më datë 27 Korrik 2023 nëpërmjet postës elektronike, palëve në këtë proces i është kërkuar paraqitja e pretendimeve përfundimtare përpara se të vijohet me vendimmarrje. Personi përgjegjës

për raportimin e veprimtarive publike, në përfundim të afatit për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare nuk i është përgjigjur kërkesës sonë për bashkëpunim.

Në përfundim të hetimit administrativ, pas administrimit të provave dhe fakteve vlerësoj se:

Neni 91, pika 1, e Kodit Zgjedhor parashikon se, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, **nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor**, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”.

Në zbatim të këtij neni, Komisioni Rregullator ka miratuar vendimin nr. 9, datë 24.12.2020. Çdo dispozitë e tij duhet të lexohet në kuadër të kërkesave dhe qëllimeve që ka këto nene. Qëllimi i dispozitës është që të garantojë paanshmëri dhe trajtim të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për **mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime zgjedhore**.

Kryetari i bashkisë së Tiranës z. Veliqaj, njëkohësisht kandidat për kryetar bashkie në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, më datë 19 Prill 2023 në funksion të detyrës së tij ka marrë pjesë në mbledhjen e këshillit bashkiak Tiranë.

Mbledhja e Këshillit Bashkiak është transmetuar live në faqen e rrjetit social “Facebook” të bashkisë Tiranë dhe rezulton ende të jetë e postuar në këtë faqe.

Neni 64, i ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, përcakton kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë. Kryetari i bashkisë raporton para këshillit sa herë kërkohet prej tij. Përgjatë fjalës së z. Veliqaj, si titullar i institucionit që drejton, nuk u arrit të provohej se ky i fundit ka promovuar punën e institucionit publik, por vërehet se fjala e tij është në funksion të raportimit lidhur me zbatimin dhe implementimin e akteve dhe politikave të ndjekura nga ky organ, si pasojë e detyrës së tij funksionale.

Referuar nenit 45 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Këshilli bashkiak përbëhet nga këshilltarë të zgjedhur, sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Vendimi 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator, në pikën 2, të nenit 3, përcakton rrethin e subjekteve që ngarkohen me zbatimin e detyrimeve që burojnë nga Kodi Zgjedhor dhe ky vendim. Konkretisht, në vendimin 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, nuk përcaktohen kufizime apo ndalim që i atribuohen mbledhjeve të këshillit bashkiak, i cili për nga natyra e tij është organ përfaqësues i bashkisë, siç parashikon edhe neni 7 i ligjit nr. 139/ 2015 “Për

vetëqeverisjen vendore”. Këshilli bashkiak është organ i zgjedhur nëpërmjet votimit për organet për qeverisjen vendore.

Për sa kohë anëtarët e këshillit bashkiak janë përfaqësues të partive politike, nuk u ndalohet e drejta për të shprehur mendime me karakter politik.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj kryetarit të bashkisë Tirnaë, nuk përbën shkelje të neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

### **V E N D O S:**

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj z. Erion Veliaj, kryetar dhe njëkohësisht kandidat për kryetar për bashkinë Tiranë.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data 10 Tetor 2023

Nr: 799  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit, për shkelje administrative”